



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 767 Akti

Nr. 675 Vendimi
Tiranë, më 16.6.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Xhensila Pine	Kryesuese
Alma Faskaj	Relatore
Valbona Sanxhaktari	Anëtare

asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore, znj. Albana Plaka, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në datën 13.6.2023, ora 14:00, mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Alfred Balla**, ndihmës ligjor në Gjykatën e Lartë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b** i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

Subjekti i rivlerësimit, z. Alfred Balla, ka ushtruar detyrën e ndihmësit ligjor pranë Gjykatës së Lartë, detyrë në të cilën është emëruar në datën 2.4.2012¹. Këtë detyrë subjekti e ka ushtruar deri në nxjerrjen e urdhrin nr. ***, datë 31.7.2017, “Për lirim nga detyra”, të kryetarit të Gjykatës së Lartë.

¹ Emëruar me urdhrin nr. ***, datë 2.4.2012, të kryetarit të Gjykatës së Lartë.

1. Z. Alfred Balla, bazuar në nenin 179/b, pika 4 e Kushtetutës dhe nenin 1652 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, bën pjesë në subjektet e rivlerësimit që i përkasin kategorisë së rivlerësimit *ex officio*.
2. Komisioni, në datën 12.2.2021, organizoi shortin për subjektin e rivlerësimit, z. Alfred Balla, duke miratuar në përbërje të trupit gjykues, i cili do të kryejë procesin e rivlerësimit të subjektit, relatore Alma Faskaj dhe anëtare të trupit komisionere Valbona Sanxhaktari dhe Xhensila Pine.
3. Subjektit të rivlerësimit, në datën 10.1.2022, iu dërgua përbërja e trupit gjykues në rrugë elektronike.
 - 3.1 Me *email*-in e datës 10.1.2022, subjekti i rivlerësimit, z. Alfred Balla, depozitoi në Komision pretendimet e tij mbi këtë proces, duke pretenduar për largim pa pëlqimin e tij dhe duke kërkuar ndërprerjen e procesit të rivlerësimit pa një vendim përfundimtar, si më poshtë:
 - 3.2 Është emëruar ndihmës ligjor pranë gjyqtarit A.M në Gjykatën e Lartë, me urdhrin nr. ***, datë 2.4.2012, të kryetarit të kësaj Gjykate. Në momentin që ishte në këtë detyrë, doli ligji për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve, i cili përfshinte edhe ndihmësit e këshilltarët ligjorë në Gjykatën e Lartë. Ka bërë, sipas ligjit, dorëzimin e deklaratës *Vetting* pranë ILDKPKI-së, pranë DSIK-së dhe të tria akteve ligjore pranë ish-KLD-së; ka punuar për gati 5 vjet në këtë pozicion dhe, me përfundimin e mandatit të gjyqtarit, kryetari i Gjykatës së Lartë, me urdhrin nr. ***, datë 31.7.2017, ka vendosur “lirimin nga detyra”, pasi ka përfunduar afati i kontratës së punës.
 - 3.3 Momenti i largimit përfundimtar nga detyra në Gjykatën e Lartë është data 15.9.2017, pasi bëri edhe dorëzimet e duhura të dosjeve sipas urdhrin. Me hapjen e garës nga Avokati i Popullit, në datën 30.11.2017, ka aplikuar për pozicionin kushtetues të anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si pjesë e Shoqërisë Civile. Me vendim të Kuvendit të Shqipërisë, në datën 8.2.2018 u zgjodh anëtar i KLP-së, si pjesë e Shoqërisë Civile (KLP ka në përbërje 2 pedagogë, 2 avokatë, 1 përfaqësues të Shoqërisë Civile dhe 6 prokurorë).
 - 3.4 Në datën 9.12.2018, KLP-ja u konstituua dhe ai është anëtar i saj, tashmë me statusin e kryetarit të këtij organi, me mandat 5-vjeçar, deri në datën 18.12.2023.
 - 3.5 Pas 3 vitesh largimi nga detyra, për të testuar problemin juridik të ruajtjes apo jo të statusit juridik të ndihmësit ligjor, duke parë një praktikë të KLGJ-së, subjekti ka ndjekur rrugën ligjore të procesit ligjor, si dhe i ka drejtuar kërkesë KLGJ-së lidhur me statusin e tij.
 - 3.6 Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 29.7.2021, vendosi: *“Pranimin e pjesshëm të kërkesë-padisë; detyrimin e palës së paditur, Gjykatës së Lartë, që t’i paguajë paditësit dëmin nga ndërprerja e marrëdhënies së punës në masën e pagesës për periudhën 16.9.2017 – 14.2.2018; rrëzimin e padisë për pjesën tjetër të saj; shpenzimet gjyqësore në masën 1/2 i ngarkohen palës së paditur, Gjykatës së Lartë”*. Gjykata e Lartë dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor mbajtën gjatë gjykimit qëndrimin se subjekti ka humbur statusin në momentin që i është ndërprerë marrëdhënia e punës. Subjekti dhe Gjykata e Lartë kanë ushtruar ankim pranë Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë. Kjo çështje ka qenë e pagjykuar derisa, në datën 4.4.2023, subjekti iu drejtua me një shkresë Komisionit, ku e informon lidhur me vendimin nr. ***, datë 10.3.2023, të Gjykatës Administrative të Apelit

² Dispozita kalimtare për ndihmësit ligjorë, këshilltarët e gjyqtarëve dhe inspektorët jomagjistratë: *“1. Këshilltari i gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësi ligjor pranë Prokurorisë e Përgjithshme dhe në gjykatat administrative, si dhe Inspektori në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, që nuk gëzon statusin e gjyqtarit ose prokurorit, janë subjekt i procesit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*”.

Tiranë, e cila ka vendosur “Prishjen e vendimit nr. ***, datë 29.07.2021, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe rrëzimin e kërkesëpadisë”.

3.7 Për kërkesën në KLGJ, me vendimin nr. ***, datë 23.12.2020, ky organ ka vendosur: “Pezullimin e shqyrtimit të kërkesës së paraqitur nga z. Alfred Balla, për deklarimin e pasjes/njohjes së statusit të këshilltarit/ndihmësit ligjor jomagjistrat pranë Gjykatës së Lartë, për shkak se kërkesa është në shqyrtim pranë Gjykatës”.

4. Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit depozitoi në Komision opinionin për vijimin e procesit të rivlerësimit të subjektit me prioritet.

5. Trupi gjykues, në datën 9.11.2022, shqyrtoi pretendimet e subjektit lidhur me procesin e rivlerësimit të tij dhe vendosi për vijimin e procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Alfred Balla, duke arsyetuar se:

5.1 Në analizë të nenit 165 “Dispozitat tranzitore”, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, trupi gjykues vlerësoi se z. Balla duhet t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit, pasi ai gëzonte “statusin e subjektit të ligjit”. Në nenin 165, në paragrafët 1 dhe 2 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” parashikohet se: *“1. Këshilltari i gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësi ligjor pranë Prokurorisë e Përgjithshme dhe në gjykatat administrative, si dhe inspektori në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, që nuk gëzon statusin e gjyqtarit ose prokurorit, janë subjekt i procesit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” 2. Subjektet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni vazhdojnë të qëndrojnë përkohësisht në detyrë, në përputhje me parashikimet ligjore, përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, përveç kur marrëdhënia e punës përfundon për arsye ligjore ose si rezultat i procesit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.*

5.2 Rezultoi e provuar se z. Balla e ka humbur funksionin si këshilltar ligjor/ndihmës ligjor në Gjykatën e Lartë, për shkak të përfundimit të marrëdhënieve të punës, me mbarimin e mandatit të anëtarit të Gjykatës së Lartë, z. A.M. Ky vendim ishte bërë objekt i një procesi gjyqësor, me objekt “Detyrimin e palës së paditur t’i njohë paditësit statusin e këshilltarit/ndihmësit ligjor jomagjistrat në Gjykatën e Lartë e të rikthejë z. Alfred Balla në detyrën e këshilltarit ligjor pranë kësaj gjykate si pasojë e pavlefshmërisë së urdhrit nr. ***, datë 31.7.2017, të kryetarit të Gjykatës së Lartë, duke pranuar vetëm rregullimin e pasojave financiare të urdhrit nr. ***, datë 31.7.2017”. Sa më sipër, në kushtet kur z. Balla e kishte bërë objekt të një procesi gjyqësor vendimin e lirimit nga detyra si këshilltar ligjor, ky vendim nuk mund të konsiderohej në këtë fazë të procesit si një vendim i cili sjell si pasojë ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për arsye ligjore, siç kërkohet nga neni 165, pika 2 e ligjit nr. 96/2016.

5.3 Nga ana tjetër, emërimi i z. Balla në detyrën e anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe statusi që ai gëzon sot, në bazë të nenit 102 të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, nuk ka asnjë pasojë për vijimin e procesit të rivlerësimit.

6. Me *email*-in e datës 12.12.2022 dhe me anë të rrugës postare në datën 14.12.2022, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar pezullimin e procedurës së rivlerësimit kalimtar të tij deri në përfundimin e procesit gjyqësor dhe daljen e gjykatës me një vendim të formës së prerë lidhur me çështjen e pasjes ose jo nga ana e tij të statusit të këshilltarit të Gjykatës së Lartë.

7. Trupi gjykues, në datën 19.12.2022, mori një vendim për mospranimin e kërkesës dhe vijimin e procesit të rivlerësimit, duke arsyetuar se:

8. Procesi i rivlerësimit është një proces i kufizuar në kohë. Natyra e veçantë e këtij procesi nuk i bën automatikisht të zbatueshme dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative, të cilat kanë për objekt parashikimin e rregullave procedurale për veprimtarinë e organeve të administratës publike. Është e qartë, por edhe detyrim ligjor për një organ administrativ që, kur vijueshmëria e tij varet nga një vendimmarrje tjetër, qoftë kjo edhe gjyqësore, të vlerësojë pezullimin ose jo të procesit administrativ, derisa vendimmarrja tjetër të përfundojë. Në rastin konkret, duke qenë se veprimtaria e organeve të rivlerësimit është e kufizuar në kohë dhe nisur nga fakti se juridiksioni i posaçëm i organeve të rivlerësimit ka të bëjë me procesin në vetvete, trupi gjykues çmoi mospezullimin e procesit dhe vijimin e tij. Trupi gjykues gjithashtu çmoi se në kushtet kur ky proces do të vijojë me një vendimmarrje të caktuar, ai do të rivlerësojë përsëri rrethanat faktike dhe ligjore. Në këtë rast, ajo që prevaloi ishte interesi publik për shmangien e vonesave në kryerjen e procesit të rivlerësimit.

9. Subjekti depozitoi në Komision një ankim ndaj vendimit të mospranimit të kërkesës për pezullimin e procesit të rivlerësimit.

10. Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit paraqiti opinionin se ankimi i paraqitur në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit (në vijim Kolegji) përmes Komisionit nuk duhet të pranohet nga ky i fundit dhe nuk duhet t'i përcillet/dërgohet Kolegjit, pasi ai vendim i ndërmjetëm procedural mund të ankimohej vetëm me një ankimim eventual kundër vendimit të Komisionit që ka gjykuar/rivlerësuar subjektin e rivlerësimit. Një vendim tjetër procedural do të binte në kundërshtim me ligjin dhe me një proces ekonomik gjyqësor.

11. Trupi gjykues, me vendimin nr. 4, datë 30.1.2023, vendosi mospranimin e ankimit të subjektit të rivlerësimit. Vendimi i arsyetuar i është njoftuar subjektit të rivlerësimit.

12. Subjekti i rivlerësimit, z. Alfred Balla, është emëruar këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë, me vendimin datë 2.4.2012, me gjyqtarin A.M. Z. Balla ka punuar për 5 vjet në këtë pozicion dhe me urdhrin nr. ***, datë 31.7.2017, "Për lirim nga detyra" të kryetarit të Gjykatës së Lartë, ai është liruar nga ky pozicion (këshilltar ligjor), pasi gjyqtarit M, pranë të cilit punonte, i ka mbaruar mandati.

13. Rezultoi se subjekti ka plotësuar të gjitha dokumentet e nevojshme lidhur me procesin e *Vetting*-ut, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016. Për sa i përket kriterit të aftësisë profesionale³, rezulton se z. Balla, ish-këshilltar ligjor i Gjykatës së Lartë, nuk mori pjesë në provimin për rivlerësimin kalimtar *ex officio*, të organizuar nga Shkolla e Magjistraturës në datat 7 dhe 8 maj 2018.

14. Kuvendi i Shqipërisë, me vendimin nr. *** "Për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë", ka përzgjedhur si anëtar nga Shoqëria Civile z. Balla. Ky vendim ka hyrë në fuqi në datën 14.2.2018.

15. Subjekti i rivlerësimit Alfred Balla ka depozituar në Komision në rrugë elektronike (me email) dokumentacionin⁴ e emërimit, lirimit nga detyra pranë Gjykatës së Lartë, si dhe dokumentacionin provues ligjor, në të cilin mbështet deklaratimet dhe shpjegimet e lartpërmendura.

³ Me shkresën e datës 18.6.2018.

⁴ Ankim nr. *** prot., datë 3.9.2021, drejtuar Gjykatës së Apelit Administrativ kundër vendimit nr. ***, datë 29.7.2021; deklaratë mbrojtjeje nr. ***, datë 23.11.2020, e Këshillit të Lartë Gjyqësor, depozituar në procesin administrativ me palë paditëse z. Alfred Balla, të paditur Gjykatën e Lartë, person i tretë Këshilli i Lartë Gjyqësor, me objekt "Detyrimin e palës së paditur t'i njohë paditësit statusin e këshilltarit/ndihmësit ligjor jomagjistrat në Gjykatën e Lartë e të rikthejë z. Alfred Balla në detyrën e këshilltarit ligjor pranë kësaj gjykate si pasojë e pavlefshmërisë së urdhrin nr. **, datë 31.7.2017, të kryetarit të Gjykatës së Lartë; detyrimin e palës së paditur t'i paguajë paditësit pagën nga data 16.9.2017 deri në datën 19.12.2018, ditë e konstituimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë; detyrimin e palës së paditur t'i paguajë paditësit të gjitha shpenzimet procedurale"; vërtetim nr. *** prot., datë 30.1.2017, me të cilin vërtetohet se subjekti Alfred Balla ka dorëzuar në ILDKPKI deklaratën *Vetting* në datën 30.1.2017; kërkesëpadi datë 15.9.2020, me palë paditëse Alfred Balla, të paditur Gjykatën e Lartë, person i tretë Këshilli i Lartë Gjyqësor, me objekt "Detyrimin e palës

16. Komisioni mori informacion nga Kuvendi lidhur me procedurat e ndjekura për përzgjedhjen e subjektit si anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

17. Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr.***, datë 24.05.2023, vendosi “Përfundimin pa vendim përfundimtar të shqyrtimit të kërkesës për pasje /njohje të statusit të këshilltarit/ndihmësit ligjor jomagjistrat të Z. Alfred Balla, për shkak të heqjes dorë”.

VLERËSIMI I KOMISIONIT

18. Komisioni, në ushtrim të kompetencave të tij të dhëna me ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, është shprehur me vendim fillimisht se z. Balla duhet t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit, pasi:

18.1 Ai kishte bërë objekt konflikti gjyqësor pikërisht vendimin e tij të largimit dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë disponoi për rrëzimin e objektit të kërkimit në padi për detyrimin e palës së paditur t’i njohë paditësit statusin e këshilltarit/ndihmësit ligjor jomagjistrat në Gjykatën e Lartë e të rikthejë z. Alfred Balla në detyrën e këshilltarit ligjor pranë kësaj gjykate, si pasojë e pavlefshmërisë së urdhrimit nr. ***, datë 31.7.2017, të kryetarit të Gjykatës së Lartë, duke pranuar vetëm rregullimin e pasojave financiare të urdhrimit nr. ***, datë 31.7.2017.

18.2 Në referim të pikës 2 të nenit 165 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, e cila bën një përjashtim nga vazhdimi i procesit të rivlerësimit dhe statusi i subjektit të rivlerësimit humbet kur marrëdhënia e punës përfundon për arsye ligjore, si dhe në kushtet kur z. Balla kishte ankimuar ligjshmërinë e urdhrimit nr. ***, datë 31.7.2017, të Gjykatës së Lartë, për shkarkimin e tij nga detyra, ai nuk përbente një nga rastet kur procesi i rivlerësimit duhej të përfundonte pa një vendim përfundimtar.

së paditur t’i njohë paditësit statusin e këshilltarit/ndihmësit ligjor jomagjistrat në Gjykatën e Lartë e të rikthejë z. Alfred Balla në detyrën e këshilltarit ligjor pranë kësaj gjykate si pasojë e pavlefshmërisë së urdhrimit nr. ***, datë 31.7.2017, të kryetarit të Gjykatës së Lartë; detyrimin e palës së paditur t’i paguajë paditësit pagën nga data 16.9.2017 deri në datën 19.12.2018, ditë e konstituimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë; detyrimin e palës së paditur t’i paguajë paditësit të gjitha shpenzimet procedurale”; kërkesë për konkurrim në pozicionin e punës këshilltar ligjor pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, nr. *** prot., datë 23.10.2017; kërkesë për ndërprerje të procesit të rivlerësimit fillestar nr. *** prot., datë 22.6.2018, drejtuar Komisionit të Pavarur të Kualifikimit; njoftimin datë 18.12.2017, për kualifikim nga Shoqëria Civile; shkresë të Avokatit të Popullit “Njoftim për plotësim dokumentacionit”, datë 5.12.2017; shkresë plotësim dokumentacioni të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, nr. *** prot., datë 8.1.2018; urdhër emërimi nr. ***, datë 2.4.2012, për emërimin si ndihmës ligjor pranë gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, z. A.M; urdhër “Për lirim nga detyra”, me të cilin është urdhëruar lirimi nga detyra e ndihmësit ligjor të z. Balla, pasi ka mbaruar afati i kontratës së punës me mbarimin e mandatit të anëtarit të Gjykatës së Lartë z. A.M; vendim nr. ***, datë 23.12.2020, “Për shqyrtimin e kërkesës për pasjen/njohjen e statusit të këshilltarit/ndihmësit ligjor jomagjistrat pranë Gjykatës së Lartë”, me të cilin është vendosur pezullimi i shqyrtimit të kërkesës për deklarimin pasjen/njohjen e statusit të këshilltarit/ndihmësit ligjor jomagjistrat pranë Gjykatës së Lartë, për shkak se kërkesa është në shqyrtim nga Gjykata e Lartë; vërtetim nga Shkolla e Magjistraturës nr. ***, datë 18.6.2016, me të cilin vërtetohet se z. Alfred Balla nuk ka marrë pjesë në testimin aftësive profesionale të subjekteve *ex officio* të organizuar nga Shkolla e Magjistraturës në datat 7 dhe 8 maj 2018; vërtetim pune datë 29.7.2017, i Gjykatës së Lartë, me të cilin vërtetohet se prej datës 2.4.2012 deri më 15.9.2017 z. Balla ka punuar si ndihmës ligjor në Gjykatën e Lartë pranë gjyqtarit të Gjykatës së Lartë A.M; vërtetim datë 19.1.2022, i Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë, me të cilin vërtetohet se pranë kësaj Gjykate është regjistruar çështja me palë paditëse z. Alfred Balla, të paditur Gjykatën e Lartë, Këshillin e Lartë Gjyqësor, me objekt “Detyrimin e palës së paditur t’i njohë paditësit statusin e këshilltarit/ndihmësit ligjor jomagjistrat në Gjykatën e Lartë e të rikthejë z. Alfred Balla në detyrën e këshilltarit ligjor pranë kësaj gjykate si pasojë e pavlefshmërisë së urdhrimit nr. ***, datë 31.7.2017, të kryetarit të Gjykatës së Lartë; detyrimin e palës së paditur t’i paguajë paditësit pagën nga data 16.9.2017 deri në datën 19.12.2018, ditë e konstituimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë; detyrimin e palës së paditur t’i paguajë paditësit të gjitha shpenzimet procedurale”.

- 18.3** Nëse i referohemi jurisprudencës së Kolegjit⁵, e cila është shprehur se: “Në kushtet kur ndryshimet kushtetuese që normuan rivlerësimin e gjetën subjektin e rivlerësimit në një nga detyrat e përmendura nominalisht nga pika 3 e kësaj dispozite, ajo ishte subjekt rivlerësimi *ex officio*. Ky fakt qëndron, është i pakontestueshëm dhe autonom nga momenti kur statusi i magjistratit deklarohet i mbaruar nga institucionet përkatëse.”
- 18.4** Në vijim, ndryshimet kushtetuese e gjetën subjektin në një nga detyrat e përmendura në pikën 4 të dispozitës kushtetuese, duke e bërë atë një subjekt rivlerësimi *ex officio*, pavarësisht nga fakti se pas hyrjes në fuqi të ligjit të rivlerësimit funksioni i tij u ndërpre, për të vijuar pas disa kohësh në një pozicion tjetër shtetëror, po me status magjistrati.
- 18.5** Në të njëjtin vendim, Kolegji shprehet se: “Qartazi, në momentin kur u miratuan dhe hynë në fuqi ndryshimet kushtetuese që përfshinë edhe këtë dispozitë – korrik dhe gusht 2016 respektivisht – subjekti i rivlerësimit, znj. E.Q, ishte gjyqtare. Nëse do të pranohej argumenti i saj, nga procesi i rivlerësimit do të përjashtoheshin me sukses të gjitha subjektet që nuk ishin në detyrë në momentin kur u vinte radha të shortoreshin apo çështja e tyre të shqyrtohej nga Komisioni, gjatë gjithë harkut kohor prej 5 vjetësh, që përbën mandatin e këtij të fundit, megjithëse e gëzonin këtë cilësi me hyrjen në fuqi të ligjit. Kësisoj, procesi i rivlerësimit do të përfshinte subjektet mbi baza tejet rastësore, të kushtëzuara thjesht nga shorti i Komisionit dhe përfundimi ose jo i rivlerësimit deri në momentin, në kohën kur për një arsye të caktuar, nuk kryenin më detyrën që i kishte cilësuar si subjekte rivlerësimi. Asgjë në frymën apo gjuhën e normave kushtetuese e ligjore nuk mbështet këtë këndvështrim selektiv të parashtruar nga subjekti, përkundrazi. Për nga natyra gjithëpërfshirëse, procesi i rivlerësimit në mënyrë specifike është parashikuar nga kushtetutëbërësi të përfshijë, së pari dhe shprehimisht, magjistratët/subjektet e rivlerësimit që, si subjekti, shërbenin në majat më të larta të drejtësisë shqiptare, por edhe këshilltarët ligjorë apo inspektorët e KLD-së jomagjistratë”.
- 18.6** Kolegji⁶, në vendimin e subjektit I.H, arsyeton: “...Në lidhje me çështjen e dytë të shtruar për zgjidhje, Kolegji, duke përdorur si bazë konkluzionin e arritur më sipër, lidhur me humbjen e statusit të magjistratit prej subjektit, shqyrtoi legjislacionin e zbatueshëm në rastin konkret dhe, sipas kësaj analize, konkludoi se procesi i rivlerësimit nuk mund të vazhdojë për një subjekt rivlerësimi që nuk e gëzon më këtë status në momentin e dhënies së vendimit. I gjithë procesi i rivlerësimit, i konceptuar dhe miratuar si një proces që do t'i shërbejë qëllimit kushtetues të pastrimit të radhëve të magjistratëve nga individë që nuk e gëzojnë besimin e publikut, u adresohet të gjithë atyre që janë pjesë e sistemit të drejtësisë. Ky proces nuk është parashikuar të jetë për se një qëllim edhe për ata që nuk janë më pjesë e këtij sistemi. Qëllimi kushtetues në këto raste është realizuar nëpërmjet mekanizmave të tjerë ligjorë, siç është në këtë rast, shkarkimi i subjektit nga detyra e gjyqtarit për shkak të dënimit me një vendim penal për kryerjen e një krimi...”
- 19.** Në datën 4.4.2023, subjekti iu drejtua me një shkresë Komisionit, e cila u administrua nga trupi gjykues, ku e informon lidhur me vendimin nr. ***, datë 10.3.2023, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, e cila ka vendosur “Prishjen e vendimit nr. ***, datë 29.97.2021, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe rrëzimin e kërkesëpadisë”.
- 20.** Subjekti i rivlerësimit, z. Alfred Balla, në datën 30.5.2023, me anë të postës elektronike, është njoftuar nga Komisioni lidhur me procesin e rivlerësimit dhe, në kuadër të një procesi të rregullt e në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, Komisioni e ka ftuar të shprehë vullnetin e tij në seancën

⁵ Vendimi i Kolegjit nr. ***, datë 12.2.2021, pika 36.2.

⁶ http://kpa.al/ep-content/uploads/2021/12/Vendimi_I.H_anonimizuar-2.pdf

dëgjimore, fokusi i së cilës do të ishte përfundimi i procesit të rivlerësimit pa një vendim përfundimtar.

21. Z. Alfred Balla konfirmoi marrjen dijeni dhe dakordësinë me rezultatet e hetimit, duke vënë në dijeni Komisionin për mospjesëmarrje në seancë dëgjimore.

22. Në këto kushte, duke rivlerësuar situatën ligjore dhe faktike të subjektit të rivlerësimit z. Balla, trupi gjykues çmon se:

22.1 Vendimi i largimit nga detyra e ndihmësit ligjor në Gjykatën e Lartë të subjektit është një vendim administrativ, i cili, pavarësisht diskutimeve lidhur me ligjshmërinë e tij, është në fuqi dhe nuk ka asnjë formë ligjore që ai të ndryshohet apo të shfuqizohet.

22.2 Ky vendim qartazi nuk është një akt që përputhet me vullnetin e subjektit, qoftë edhe në mënyrë të heshtur. Subjekti e kishte bërë këtë akt objekt të ankimit gjyqësor, duke konsideruar faktin se ky vendim nuk ishte për shkaqe ligjore. Ky proces tashmë është i përfunduar, duke vendosur gjykata për rrëzimin e padisë. Për pasojë, ky largim ligjërishit duhet të konsiderohet si përfundim i marrëdhënies së punës së subjektit të rivlerësimit për arsye ligjore, tashmë i padiskutueshëm si në rrugë administrative, edhe gjyqësore.

22.3 Është e provuar se në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016 subjekti ka qenë subjekt *ex officio* i ligjit. Por humbja e këtij statusi nuk ka ardhur si pasojë as e përfundimit të procesit të rivlerësimit, as e dorëheqjes së tij, por si pasojë e një akti që ka vendosur ndërprerjen e marrëdhënies së punës së tij.

22.4 Në bazë të nenit 165, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ku parashikohet se: “2. *Subjektet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni vazhdojnë të qëndrojnë përkohësisht në detyrë, në përputhje me parashikimet ligjore, përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, përveç kur marrëdhënia e punës përfundon për arsye ligjore ose si rezultat i procesit të rivlerësimit në përputhje me ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, për shkak të periudhës tranzitore dhe legjislacionit të reformës në drejtësi, subjekti duhet të qëndronte në detyrë përkohësisht deri në përfundimin e procesit të rivlerësimit. Ai nuk ka qëndruar në detyrë jo për “faj” të tij, por si pasojë e nxjerrjes së një akti për ndërprerjen e marrëdhënies së tij të punës. Kjo marrëdhënie ka qenë, sipas legjislacionit të mëparshëm, e lidhur me kohëzgjatjen e mandatit të gjyqtarit përkatës, por me hyrjen në fuqi të ligjeve të reformës në drejtësi duhet të prevalonin pikërisht këta të fundit.

22.5 Në kushtet kur jemi para një akti i cili tashmë është në fuqi, për pasojë mund të konsiderohet si një ndërprerje e marrëdhënies së punës për arsye ligjore. Jurisprudenca e Kolegjit apo edhe e Komisionit, e deritanishme në interpretimin e “arsyeve ligjore”, ka qenë kur statusi i magjistratit ka humbur për shkak të daljes në pension, vdekja apo dënimi me një vendim penal të formës së prerë. Nëse është ligjor ose jo ky vendim, nuk është çështje e juridiksionit dhe kompetencës së organeve të rivlerësimit. Ajo që organet kanë tagër, është pikërisht kryerja e procesit për subjektet e ligjit, përveç rasteve kur statusi mbaron për arsye ligjore apo me dorëheqje të shprehur apo të heshtur të subjekteve. Kolegji arsyeton se: “...*Akti i dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit, i bërë efektiv në datën 30.4.2017, sipas të cilit që nga data 1.5.2017, ...nuk do të mund të ushtronte detyrën si këshilltare ligjore pranë Gjykatës Kushtetuese, sjell si pasojë humbjen e statusit si subjekt rivlerësimi (ex officio), në kuadër të përcaktimit kushtetues të nenit 179/b, pika 4 e Kushtetutës, si dhe pamundësinë e realizimit të qëllimit të procesit të rivlerësimit, duke pasur parasysh që, referuar nenit 165 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe nenit 58, pika 1, nënparagrafët “a”, “b”, “c” të ligjit nr. 84/2016, qëllimi për kryerjen e procesit të*

rivlerësimit, i parashikuar në pikën 1 të nenit 179/b të Kushtetutës realizohet, përfundimisht, nëpërmjet konfirmimit në detyrë apo shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit (pa marrë në konsideratë pezullimin shoqëruar me edukim të detyrueshëm, duke qenë se kjo është masë e përkohshme, e cila në vijim do të përfundojë me vendimmarrje të organit rivlerësues për konfirmim në detyrë apo shkarkim)⁷”.

- 22.6** “Arsyet ligjore” të identifikuar në këtë mënyrë nuk mund të konsiderohen si një listë shteruese, por Komisioni si organ rivlerësimi është i detyruar ligjërisht t’i vlerësojë ato sipas veçorive të rastit konkret, mbi të gjitha kur nuk është e mundur të identifikohet vullneti i shprehur ose i heshtur i një subjekti rivlerësimi për të dhënë dorëheqjen – sepse kjo mund të konsiderohet si joproporcionale.
- 22.7** Situata faktike, ku subjekti i rivlerësimit humbi vendin e punës, për arsye përtej vullnetit të tij (në thelb u pushua nga puna), mund të cilësohet si “arsye ligjore”, pavarësisht nëse ishte ose jo e justifikuar në bazë të ligjit (sepse ndoshta akti i shkarkimit të tij ishte i paligjshëm).
- 22.8** Subjekti i rivlerësimit, Alfred Balla, tërhoqi kërkesën e tij në Gjykatën Administrative dhe ky veprim është legjitim, pasi askush nuk mund të detyrohet të ndjekë një çështje në gjykatë, edhe nëse ka të drejtë. Ky veprim i subjektit nuk mund të na çojë në një konkluzion negativ, të tillë si, se kjo heqje dorë nënkupton ekzistencën e vullnetit për dorëheqje. Për pasojë, zbatimi i nenit G do të ishte joproporcional edhe sipas nenit 8 të KEDNJ-së, edhe sipas parimit të disponueshmërisë së të drejtave procedurale.
- 22.9** Sa më sipër, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit, z. Alfred Balla, ka humbur përfundimisht statusin e subjektit të rivlerësimit lidhur me funksionin e tij të mëparshëm, nga i cili u shkarkua (edhe pse është ende në sistem, por për shkak të një ngjarjeje të mëvonshme ligjore nga Kuvendi). Ai nuk ka më vazhdimësi të statusit të subjektit të rivlerësimit, i cili ka ekzistuar deri në momentin që çështja ishte në shqyrtim në Gjykatën Administrative. Për pasojë, nuk është e mundur dhe do të ishte joproporcionale nëse do të trajtohej kjo situatë faktike dhe ligjore në kuptim të nenit G. Në rastin konkret, në bazë të parimit të proporcionalitetit, subjekti nuk mund të konsiderohet nën nenin G të Kushtetutës, pasi nuk kemi një dorëheqje të subjektit nga detyra me qëllim moskryerjen e procesit të rivlerësimit dhe mbarimi i mandatit të gjyqtarit është një çështje e pavarur nga vullneti i tij dhe, për pasojë, situata juridike dhe faktike nuk mund të konsiderohet si një dorëheqje.
- 22.10** Për këtë arsye, trupi gjykues çmon se në rastin konkret jemi para zbatimit të nenit 103 të Kodit të Procedurave Administrative, ku parashikohet se: *“1. Procedimi administrativ përfundon kur organi administrativ kompetent për marrjen e vendimit përfundimtar zbulon se objekti për të cilin kishte filluar procedimi ose qëllimi i vendimit është bërë i pamundur. 2. Deklarimi i përfundimit të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni duhet të jetë gjithnjë i arsyetuar dhe kundër tij mund të bëhet ankim në gjykatë”*

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në nenin 179/b, pika 4 e Kushtetutës dhe në nenin 57 të ligjit nr. 84/2016, nenit 95 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”,

⁷ Vendimi nr. ***, datë 25.7.2019.

V E N D O S I:

1. Të deklarojë përfundimin e procesit të rivlerësimit pa një vendim përfundimtar për z. Alfred Balla.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të këtij vendimi.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, më 16.6.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Xhensila PINE
Kryesuese

Alma FASKAJ
Relatore

Valbona SANXHAKTARI
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Albana Plaka